

Vendim nr. 275 datë 15.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 15.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “EDAL”SH.P.K., përfaqësuar nga avokat Arjan Qafa, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3952, datë 26.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 547, datë 26.02.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-2259, datë 29.05.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Edal” sh.p.k. (*kërkuesja*) ka lidhur me pronarët e disa trojeve që ndodhen në qytetin e Tiranës aktmarrëveshjen e datës 06.11.2002, me të cilën palët kanë rënë dakord që me marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtimin e një godine 10-katëshe, pronarët e trojeve do të merrnin 25% të ndërtimit nga kërkuesja, duke vënë si kusht miratimin e saj brenda pesë mbledhjeve të Këshillit të Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë (KRRT) Tiranë. Me vendimin e datës 27.07.2003 të KRRT-së, Tiranë është marrë leja e ndërtimit për një godine 10-katëshe (dy kate nën tokë).

2. Në vijim, në datën 24.03.2004, mes kërkueses dhe shtetasve M.K. dhe S.K. (pronarë të një pjese të truallit ku do ndërtohej godina - palë paditëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar) është lidhur kontrata “Për dhënie trualli për ndërtim”, sipas së cilës këta të fundit i vinin në dispozicion kërkueses, në cilësinë e investitorit, sipërfaqen prej 362 m², kundrejt detyrimit të investitorit që, pas përfundimit të godinës sipas lejes së ndërtimit, t`i kalonte palës tjetër, pronarëve të truallit, gjashtë apartamente banimi, zyra, dyqane dhe dy garazhe, sipas planimetrisë dhe sipërfaqes së përcaktuar në kontratë. Në lidhje me sipërfaqen e truallit që jepej për ndërtim, nga vendimet gjyqësore rezulton se në faqen e parë të kësaj kontratë citohej se ajo ishte 362 m², duke shënuar në kllapa: “Rezulton gjithashtu se sipërfaqja e matur në vend është 410 m², bashkëlidhur akti i ekspertizës i bërë nga pala e parë”.

3. Rezulton, gjithashtu, se kërkuesja ka lidhur me shtetasin I.H. kontratën e porosisë të datës 19.07.2004, në bazë të së cilës i kalonte atij një apartament banimi me sipërfaqe 105 m².

4. Në datën 19.07.2004 shtetasit M.K. dhe S.K. kanë lidhur me shtetasin I.H. (person i tretë në procesin gjyqësor të kundërshtuar) kontratën e porosisë për kalimin atij të një apartamenti banimi me sipërfaqe 105 m², i cili përfshihej në apartamentet pjesë e listës bashkëlidhur kontratës së lidhur me kërkuesen.

5. Pas ndërtimit të godinës, mes palëve ka lindur një konflikt në lidhje me sipërfaqet takuese të pronarëve të truallit. Për rrjedhojë, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së datës 24.03.2004 të lidhur mes saj dhe shtetasve M.K. dhe S.K., duke saktësuar sipërfaqen takuese sipas përqindjes së paravendosur. Të paditurit M.K. dhe S.K. kanë paraqitur kundërpadi me objekt detyrimin e kërkueses të zbatojë kushtet e kontratës së datës 24.03.2004 të lidhur mes tyre, në lidhje me sipërfaqet ndërtimore të rena dakord dhe t`i dëmshpërblejë për fitimin e munguar dhe dëmin e ardhur nga

mosrespektimi i detyrimeve kontraktuale. Ata kanë kërkuar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur bllokimin e depozitave bankare në bankat e nivelit të dytë, si dhe bllokimin e veprimeve pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për mostjetërsim të aktiviteteve të kërkueses. Në gjykim është thirrur, si person i tretë në kundërpadi, edhe shtetasi I.H.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3952, datë 26.03.2014, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë. Pranimin pjesërisht të kundërpadisë. Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së porosisë të lidhur midis paditësit të kundërpaditur “Edal” sh.p.k. dhe personit të tretë në kundërpadi I.H., me të dhëna nr. 3516 rep. nr. 346 kol., datë 19.07.2004 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur “Edal” sh.p.k. të përmbushë detyrimin që rrjedh nga kontrata “Për dhënie trualli për ndërtim”, me të dhëna nr. 1828 rep. nr. 228 kol., datë 24.03.2004, për kalimin në favor të kundërpaditësve të apartamentit të banimit me sipërfaqe 105 m², të ndodhur në katin e tetë mbi tokë, ose i gjashtë i banimit, seksioni i parë, apartamenti nr. 5, nga lindja e godinës së banimit të ndërtuar nga pala paditëse në rrugën “Gjon Buzuku”, Tiranë, sikundër citohet në rubrikën “Objekti i kontratës dhe detyrime respektive”, pika 1.2 e kësaj kontrate. Detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur “Edal” sh.p.k. të dëmshpërblejë të paditurit kundërpaditës për përdorimin e sendit të paluajjtshëm me të dhëna apartament banimi, me sipërfaqe 105 m², të ndodhur në katin e tetë mbi tokë ose i gjashtë i banimit, seksioni i parë, apartamenti nr. 5 nga lindja e godinës së banimit të ndërtuar nga pala paditëse në rrugën “Gjon Buzuku” Tiranë, për periudhën nga data 31.12.2006 deri në datën 28.01.2014, në shumën 1,700,000 lekë. Marrjen e masës së përkohshme, sigurimin e padisë, duke bllokuar në ZVRPP, Tiranë çdo veprim administrativ transkriptimi në lidhje me pasurinë e paluajjtshme apartament banimi, me sipërfaqe 105 m², të ndodhur në katin e tetë mbi tokë ose i gjashtë i banimit, seksioni i parë, apartamenti nr. 5 nga lindja e godinës së banimit të ndërtuar nga pala paditëse “Edal” sh.p.k. në rrugën “Gjon Buzuku”, Tiranë, deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Rrëzimin e kërtimeve të tjera të parashtruara nga ana e kundërpaditësve si të pambështetura në prova e në ligj.”* Në vlerësimin e gjykatës, referuar edhe aktit të ekspertimit të ekspertit të caktuar prej saj, rezultoi i provuar fakti se nga ana e palës paditëse brenda sheshit të ndërtimit është përfshirë sipërfaqja prej 362 m², në pronësi të kundërpaditësve, si dhe sipërfaqja 48 m², e cituar prej tyre në kontratë. Eksperti ka konkluduar edhe se apartamenti i kontraktuar me personin e tretë është një nga apartamentet e kontraktuara midis paditësit dhe kundërpaditësve sipas kontratës të datës 24.03.2004. Në vlerësimin e gjykatës, në interpretim të kontratës, palët kanë qenë të

vetëdijshme në lidhje me objektin e saj, si dhe me detaje të tjera që kanë të bëjnë me matjet në terren të sipërfaqes së truallit për ndërtim. Fakti se pjesë përbërëse e saj ka qenë edhe një akt ekspertimi me anën e të cilit janë përcaktuar pozicionimi i pronës në terren dhe sipërfaqja tërësore e truallit, provon qartë se pala paditëse nuk ka qenë në lajthim në lidhje me komponentin e kontratës, sipërfaqen e truallit për ndërtim.

7. Kurse në lidhje me kërkimet e vëna në themel të kundërpadisë, gjykata ka vlerësuar se janë pjesërisht të mbështetura në ligj e prova. Sipas saj, paditësja e kundërpaditur nuk ka përmbushur një pjesë të detyrimeve kontraktore që rëndojnë mbi të për efekt të kontratës të datës 24.03.2004, konkretisht për kalimin në favor të kundërpaditësve të apartamentit të banimit me sipërfaqe 105 m², sikundër citohet në pikën 1.2 të kontratës së lidhur mes palëve. Një nga pasojat e mospërmbushjes së detyrimit në rastin konkret është shpërblimi i dëmit të ardhur kundërpaditësve të paditur, si pasojë e përdorimit pa të drejtë të sendit të paluajjtshëm për periudhën nga data 31.12.2006 deri në datën 28.01.2014. Po kështu, ajo ka gjetur të bazuar edhe kërkimin për konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së porosisë të lidhur midis kërkueses dhe shtetasit I.H., person i tretë në kundërpadi, si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, pasi ka vlerësuar se pala paditëse e kundërpaditur ka disponuar në lidhje me një të drejtë pa e pasur atë, shkak që passjell pavlefshmërinë e kontratës së lidhur me personin e tretë. Për sa u përket kërkimeve të tjera të kundërpaditësve të paditur, për shumat e kërkuara si shpërblim dëmi për mosekzekutim të detyrimeve kontraktore, ajo gjykatë i ka gjetur të pambshtetura në prova. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur ankim kërkuesja, ashtu edhe pala e paditur kundërpaditëse.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 547, datë 26.02.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3952, datë 26.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e gjetur të drejtë dhe të bazuar atë. Kundër vendimit ka ushtruar rekurs kërkuesja, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2259, datë 29.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se në të nuk ekzistojnë shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit, pasi: i) nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve; ii) palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të

rregullt ligjor; iii) gjykata e apelit ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen dhe ka kryer një analizë juridike të plotë të provave, duke e zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe duke i dhënë përgjigje ezauroese pretendimeve të ngritura nga palët; iv) vendimi i gjykatës së apelit nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të asaj gjykate.

10. Në datën 28.08.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 17.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuësës

11. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt*, pasi:

11.1.1. Gjykatat kanë lejuar mbivendosjen, duke mos i dhënë zgjidhje efektive çështjes në proces dhe duke i shkaktuar kërkuësës dëm të rëndë ekonomik. Procesi gjyqësor është bazuar kryesisht në kontratën e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, pa marrë parasysh faktet që provojnë se sipërfaqja e pronës faktike është 362 m² dhe pa analizuar si duhet provat që tregojnë ndryshimet midis sipërfaqes së deklaruar dhe asaj faktike.

11.1.2. Gjykatat kanë vendosur për palët detyrime që ligjërisht nuk mund t'i mbartin, në kuptim të nenit 195 të KPC-së. Personi i tretë nuk mund të bëhet objekt i një vendimi që përfshin detyrime ndaj tij. Edhe pse personi i tretë nuk ishte palë në proces, ndaj tij u caktuan detyrime financiare dhe nuk iu garantua e drejta për t'u përfshirë në proces dhe për të marrë pjesë aktivisht e për të paraqitur argumentet e tij.

11.1.3. Gjykatat, në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve, kanë favorizuar palën e paditur kundërpaditëse, duke mos hetuar si duhet pretendimet e kërkuësës dhe duke injoruar dokumentet që vërtetonin ndryshimin e sipërfaqes faktike të truallit për sipërfaqen 48 m². Ato nuk kanë marrë në konsideratë dokumentet që tregojnë qartë mospërputhjen e sipërfaqes faktike të truallit me atë të përfshirë në kontratë, çka është një gabim i rëndë procedural, duke krijuar një situatë të pabarabartë dhe të pafavorshme për

kërkuesen dhe duke i shkaktuar dëm ekonomik për shkak të kompensimit dy herë për të njëjtën pronë pronarët e truallit, duke u detyruar të japë sipërfaqe ndërtimi për një truall që nuk ekziston faktikisht. Gjykatat kanë trajtuar në mënyrë jo të barabartë pretendimet e palëve. Ato nuk kanë marrë në konsideratë aktin e ekspertimit të ekspertes që reflekton realitetin faktit të truallit dhe sqaron mospërputhjen e sipërfaqes, duke e injoruar këtë provë të rëndësishme, çka ka dëmtuar procesin gjyqësor dhe ka sjellë vendim të padrejtë që ka cenuar të drejtat e palës ankuese. Vendimet objekt gjykimi janë bazuar në fakte të pasakta, duke u mbështetur në kontratën e sipërmarrjes të datës 24.03.2004 të lidhur mes palëve, pa marrë parasysh realitetin faktik të sipërfaqes së truallit. Gjykatat nuk kanë realizuar një hetim të plotë për të përcaktuar me saktësi sipërfaqen e truallit, çka ka sjellë një vendim të padrejtë, që ka dëmtuar interesat e palës ankuese dhe ka krijuar një situatë të padrejtë në lidhje me të drejtat e pronësisë.

11.2. *Parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e pronës private* për shkak të mospërcaktimit të saktësisë së sipërfaqeve në kontratë dhe duke mos u adresuar nga gjykatat mospërputhja midis sipërfaqes së përfshirë në kontratë prej 410 m² dhe asaj faktike prej 362 m². Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi për shpalljen e pavlefshmërisë së kontratës në lidhje me sipërfaqen fiktive 48 m², duke kërkuar saktësimin e sipërfaqeve që duhej të kalonin në pronësi të palës së paditur, duke pretenduar se ka pasur gabim në lidhje me sipërfaqen e truallit të deklaruar gjatë lidhjes së kontratës. Kërkuesja në monumentin e lidhjes së kontratës ishte në lajthim dhe mirëbesim, duke menduar se të paditurit po i kalonin në dispozicion 410 m² truall, kur në fakt sipërfaqja ishte 362 m², për rrjedhojë sipërfaqja e apartamenteve që do u kalonte atyre ishte më e madhe nga ajo që u takonte. Detyrimi për të dhënë sipërfaqe ndërtimi për truall që nuk ekziston cenon të drejtat pronësore dhe krijon dëm ekonomik të padrejtë për kërkuesen. Mbivendosja e pronave për sipërfaqen 48 m² del e qartë nga dokumentacioni dhe gjendja faktike e përcaktuar nga ekspertët. Kjo pasiguri është përforcuar nga fakti se gjykatat nuk kanë bërë asnjë hetim të thelluar për të sqaruar situatën dhe për të përcaktuar sipërfaqen e saktë të truallit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi për ato të drejta dhe pretendime që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe interesat e saj. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se për sa i përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave dhe interesave të personit të tretë në kundërpadi, shtetasit I.H., kërkuësja, si subjekt i kushtëzuar në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, nuk ka arritur të provojë interesin e saj të drejtpërdrejtë për të kërkuar mbrojtjen e tyre përpara kësaj Gjykate.

14. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kurse për sa u përket pretendimeve për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 29.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 28.08.2024. Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur *e-mail*-i i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit vendimi i asaj gjykate i është komunikuar avokatit të kërkueses në adresën e tij elektronike në

datën 13.06.2024, e cila është edhe data kur ajo është njohur efektivisht me përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar dhe data nga e cila fillon të ecë afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor.

16. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, si dhe të parimit të sigurisë juridike e të së drejtës së pronës, duke parashtruar, në thelb, se gjykatat janë bazuar në kontratën e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, pa marrë parasysh faktet dhe provat që tregojnë ndryshimet midis sipërfaqes së deklaruar dhe asaj faktike, për sa i përket sipërfaqes 48 m². Sipas kërkeses, gjykatat nuk kanë realizuar një hetim të plotë për të përcaktuar me saktësi sipërfaqen e truallit, çka ka sjellë një vendim të padrejtë që ka dëmtuar interesat e saj dhe ka krijuar një situatë të padrejtë në lidhje me të drejtat e kërkeses, për sa kohë që i ka vendosur detyrimin për të dhënë sipërfaqe ndërtimi për truall që nuk ekziston, duke i cenuar të drejtat pronësore dhe duke krijuar dëm ekonomik të padrejtë për të.

17. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mënyrë konstante Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kolegji, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkesja, vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Kërkesja nuk ka arritur të argumentojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e të

drejtave të saj kushtetuese për shkak të mënyrës se si kanë vepruar gjykatat në rastin konkret. Për më tepër, bazuar në vendimet gjyqësore të kundërshtuara, rezulton se gjykatat kanë marrë në shqyrtim pretendimet e palëve në procesin gjyqësor, sipas kërkimeve të padisë dhe të kundërpadisë, dhe u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar atyre në drejtim të bazueshmërisë në prova dhe në ligj. Edhe Gjykata e Lartë, bazuar në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, ka marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara në rekurs, të cilat gjejnë pasqyrim edhe në vendimin e saj, duke vlerësuar se nuk janë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së që bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Arsyetimi i vendimeve objekt kërkesë në drejtim të mënyrës se si kanë vlerësuar pretendimet e kërkueses nuk rezulton të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë ose që të mos respektojë standardet kushtetuese të një vendimi të arsyetuar. Për rrjedhojë, edhe fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar nga ajo gjykatë.

19. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se për sa kohë kërkuësja nuk ka parashtruar argumente kushtetuese për të mbështetur pretendimet e saj të parashtruara në ankimin kushtetues individual, kërkimet e saj nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet *ratione materia* për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.